



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/126

Datë: 06.02.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 7 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 08/L-036 për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës Jashtë Vendit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 shkurt 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Mbrojtjes për dërgimin e Kontingjentit të FSK-së në Operacionin Ndërkombëtar Humanitar, sipas kërkesës së Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, me qëllim të dhënies së ndihmës humanitare në Republikën e Turqisë, në rajonet e prekura nga tërmeti i datës 6 shkurt 2023.
2. Mjetet financiare për dërgimin e kontingjentit të FSK-së sipas pikës një 1. të këtij Vendimi, ndahen nga organizata buxhetore - Ministria e Mbrojtjes.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që këtë Vendim t'ia dërgojë Presidentes së Republikës së Kosovës, me qëllim të dhënies së autorizimit të saj sipas legjislacionit në fuqi për dërgimin e FSK-së jashtë vendit, si dhe të njoftojë Kuvendin e Republikës së Kosovës me përmbajtjen e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Presidentes së Republikës së Kosovës
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë